



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

RAPORT

PËR REZULTATET E KONSULTIMIT PUBLIK TË PROJEKTVENDIMIT

“PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE PËR MBROJTJEN E
KONSUMATORËVE DHE MBIKËQYRJEN E TREGUT 2024- 2030”

1. Titulli i draftaktit

Projektvendim “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2024-2030”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Konsultimet në portalin e Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike kanë zgjatur 20 ditë pune, 12.10.2023 – 09.11.2023, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë.

Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit publik të përdorura si vijon:

a. Projektvendimi “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut, 2030” është konsultuar në tryeza të përbashkëta, me Shoqatat e

Mbrojtjes së Konsumatorit, me studentët e Fakultetit të Drejtësisë, Shoqatat e Biznesit dhe Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë, në datën 20 Dhjetor 2022, pranë mjediseve të Xheko Imperial.

b. Takim me donatorët dhe përfaqësues të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, në datën 27.07.2023, në mjediset e ish-Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

c. Konsultimi në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike” për periudhën 12.10.2023 – 09.11.2023. Përmes publikimit në RENJK, në zbatim të ligjit 146/2014, janë ftuar qytetarë, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik, të draft Strategjisë Ndër sektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut, 2030. Projektvendimi, relacioni shpjegues, dokumenti strategjik dhe plani i veprimit, janë publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente.

Nuk janë përcjellë komente nga konsultimi i projektvendimit “Për miratimin e Strategjisë ndër sektoriale për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Mbikëqyrjen e Tregut, 2030”, përmes portalit RENJK.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Palët e interesuara, të cilat morën pjesë në konsultimin e këtij projektakti janë:

-Shoqatat e Mbrojtjes së Konsumatorit;

-Shoqatat e Biznesit;

-Dhomat e Tregtisë dhe Industrisë;

-Qytetarë, ekspertë të fushës, shoqata dhe përfaqësues të tjerë të publikut të interesuar për të kontribuar përgjatë procesit të konsultimit publik.

Hartimi i dokumentit strategjik ka kaluar përmes një dialogu dhe kontributi të vazhdueshëm me ministrinë e linjës:, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Entet rregullatore: Enti Rregullator i Energjisë, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Enti Rregullator i Ujit, Banka e Shqipërisë, Autoriteti i Aviacionit Civil, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare; Institucionet e Infrastrukturës së cilësisë: Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, Drejtoria e Përgjithshme Metrologjisë; Institucionet mbikëqyrëse/inspektuese të tregut: Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.

Projektvendimi i është nënshtruar konsultimit publik përmes publikimit të tij në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike nëpërmjet të cilit nuk u përcollën komente.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten komentet e pranuar në lidhje me këtë projektakt:

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (i pranuar/i pranuar pjesërisht/i refuzuar)	Justifikimi
-Lidhur me strukturat përgjegjëse për monitorimin e strategjisë	-Të shtohet një parashikim lidhur me rolin që luajnë aktorët e jashtëm, si: organizatat për mbrojtjen e konsumatorëve, në procesin e monitorimit të strategjisë, si në vijim: <i>“Një rol të rëndësishëm në monitorimin e strategjisë luajnë dhe aktorët e jashtëm, si: organizatat për mbrojtjen e konsumatorëve. Nëpërmjet raporteve të ndryshme të monitorimit, jo vetëm do të bëhet vlerësimi i zbatimit të strategjisë, niveli i përmbushjes së indikatorëve, por gjithashtu do të matet niveli i përgjegjësisë së këtyre institucioneve kundrejt konsumatorëve,</i>	Shoqatat e Mbrojtjes së Konsumatorëve	Pranuar	

	<i>por dhe niveli i kënaqësisë së konsumatorëve”.</i>			
--	---	--	--	--